



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

PROCEDURËN E CERTIFIKIMIT DHE KUALIFIKIMET E PUNONJËSVE ME
FUNKSIONE KYÇE TË SHOQËRISË KOMISIONERE

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 196, datë 29.12.2020

KREU I

Të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

1. Procedurës së certifikimit të aftësisë dhe përshtatshmërisë së punonjësve me funksione kyçe të shoqërisë komisionere dhe bankës që ofron shërbime investimi në tituj.
2. Kualifikimeve që duhet të zotërojnë punonjësit me funksione kyçe të shoqërisë komisionere dhe personelit kyç të bankës që ofron shërbime investimi në tituj, në përputhje me pozicionin dhe përgjegjësitë e vendit të punës.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, nenit 38, pikat 4 dhe 7 të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për punonjësit me funksione kyçe të shoqërisë komisionere dhe personelit kyç të bankës që ofron shërbime investimi në tituj.

Neni 4

Përkufizime

1. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a. “Personel kyç” është punonjësi i bankës që kryen funksionin e brokerit, këshilltarit të investimeve, administratorit të portofolit apo ofruesit të shërbime të tjera të investimit për klientin në përputhje me veprimtaritë për të cilat është licencuar banka;
 - b. “Funksionar kryesor” është punonjësi i shoqërisë komisionere, i punësuar në pozicionet drejtuese të përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr.62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”. Ky term i referohet vetëm shoqërisë komisionere dhe nuk aplikohet për bankën e licencuar që ofron shërbime investimi në tituj;
 - c. “Punonjës me funksione kyçe”, shkurt “punonjësi” është funksionari kryesor si dhe i punësuar pranë shoqërisë komisionere që kryen funksionin e brokerit, këshilltarit të investimeve, administratorit të portofolit, apo ofruesit të informacionit apo shërbimeve të tjera të investimit për klientin në përputhje me veprimtaritë për të cilat është licencuar. Për efekt të kësaj rregulloreje, termi “punonjës me funksione kyçe”, në rastin e bankës, do të ketë të njëjtin kuptim me termin “personel kyç”;
 - d. “Dhënie informacioni” është informimi i klientëve, me kërkesë të tyre ose me iniciativën e shoqërisë, rreth instrumenteve financiare, shërbimeve të investimit apo shërbimeve ndihmëse;
 - e. “Njohuri dhe aftësi profesionale” është zotërimi nga ana e punonjësit të shoqërisë, i një kualifikimi të përshtatshëm dhe përvojës profesionale për të përmbushur detyrimet e lidhura me ofrimin e shërbimeve përkatëse të investimit apo kryerjen e funksionit të caktuar;
 - f. “Kualifikim i përshtatshëm” është një kualifikim, testim apo kurs trajnimi që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë rregullore;
 - g. “Kërkesa për kualifikim” është një nivel i kërkuar njohurish, apo certifikatë e nevojshme për funksionin që do të kryhet;
 - h. “Përvojë e përshtatshme profesionale” është aftësia e punonjësit për të kryer funksionet përkatëse, vërtetuar nga eksperiencia në punësimet e mëparshme;
 - i. “Punonjës nën mbikëqyrje” është personi që do të punojë nën monitorim, derisa të fitojë nivelin e kërkuar të kualifikimit dhe/apo përvojën e përshtatshme profesionale.
2. Të gjitha përkufizimet e tjera në këtë rregullore janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, të referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

Neni 5

Kërkesa Bazë

1. Çdo shoqëri komisionere/bankë ushtron veprimtarinë në përputhje me licencën e miratuar nga Autoriteti vetëm pas certifikimit dhe pajisjes me dokumentin për aftësi dhe përshtatshmëri të punonjësve me funksione kyçe.

2. Një person emërohet në një funksion kyç të shoqërisë komisionere/bankës vetëm pas certifikimit të tij nga këshilli i administrimit/ këshilli mbikëqyrës i shoqërisë komisionere ose njësia përgjegjëse pranë bankës së licencuar për kryerjen e shërbimeve të investimit.
3. Emërimi për funksionarin kryesor të shoqërisë komisionere është i vlefshëm për një periudhë kohore jo më të gjatë se pesë vjet. Për çdo funksionar kryesor, i cili ushtron funksione kyçe, shoqëria komisionere duhet të ketë një deklaratë përgjegjësie, ku të shprehen përgjegjësitë që duhet të kryejë funksionari kryesor në shoqëri dhe kërkesat e raportimit.
4. Funksionarët kryesorë të shoqërisë komisionere miratohen nga Autoriteti vetëm pas depozitimit nga shoqëria komisionere të dokumentit për aftësi dhe përshtatshmëri.
5. Riemërimi i funksionarëve kryesorë, në përfundim të mandatit, si dhe ndryshimi i funksionarëve kryesorë, pasi certifikohen nga shoqëria komisionere, i njoftohen Autoritetit, i cili mund të refuzojë miratimin e emërimit në përputhje me rregulloren “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”.
6. Punonjësi, i cili ka marrë certifikim për një pozicion të caktuar në një shoqëri komisionere/bankë, duhet të ricertifikohet përpara emërimit në një pozicion që kërkon certifikim në një shoqëri/ bankë tjetër.
7. Kërkesat e këtij neni zbatohen gjatë gjithë veprimtarisë së shoqërisë komisionere/ bankës së licencuar për kryerjen e shërbimeve të investimit.

Neni 6

Njoftimi në Autoritet

1. Shoqëria komisionere/banka informon Autoritetin për çdo punonjës të ri të certifikuar brenda 15 ditëve pune nga certifikimi ose për çdo punonjës që është larguar nga shoqëria për çfarëdo lloj arsyeje brenda 15 ditëve pune nga largimi.
2. Njoftimi, sipas pikës 1 të këtij neni shoqërohet me dokumentin për aftësi dhe përshtatshmëri të lëshuar nga shoqëria komisionere/banka, si dhe dokumentacionin mbështetës që vërteton se certifikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria komisionere brenda muajit mars të çdo viti, vendos në dispozicion të Autoritetit listën e punonjësve të certifikuar.
4. Autoriteti mund të kërkojë në çdo kohë informacion shtesë në lidhje me personat e certifikuar.

Neni 7
Funksionet që kërkojnë certifikim

1. Konsiderohen persona që kërkojnë certifikim nga shoqëria komisionere, çdo individ që propozohet të punësohet në funksionet si më poshtë:
 - a. Broker;
 - b. Këshilltar i investimeve;
 - c. Administrator i portofolit;
 - d. Pozicione që lidhen me dhënie informacioni apo ofrimin e shërbimeve të tjera të investimit për klientin, në përputhje me veprimtaritë për të cilat është licencuar shoqëria;
 - e. Drejtor i Departamentit të Financës;
 - f. Drejtor i Departamentit të Përputhshmërisë;
 - g. Drejtor i Departamentit të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
 - h. Drejtor i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;
 - i. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm.

2. Konsiderohen persona që kërkojnë certifikim nga banka/njësia përgjegjëse punonjësi që do të kryejë funksionet e mëposhtme:
 - a. Broker;
 - b. Këshilltar i investimeve;
 - c. Administrator i portofolit;
 - d. Shërbime të tjera të investimit për klientin në përputhje me veprimtaritë për të cilat është licencuar banka.

3. Në rast të delegimit të funksioneve të përcaktuara në pikën 1, germa e) dhe i) të këtij neni, shoqëria komisionere certifikon personin përgjegjës, i cili ushtron funksionet kyçe të deleguara, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

KREU II
CERTIFIKIMI

Neni 8
Kriteret për Aftësi dhe Përshtatshmëri

1. Për të përcaktuar nëse një person është i aftë dhe i përshtatshëm për të mbajtur një nga pozicionet e përcaktuara në nenin 7, të kësaj rregulloreje, shoqëria merr parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 13, të Ligjit nr.62/2020 “ Për Tregjet e Kapitalit”.

2. Shoqëria duhet të dokumentojë përputhshmërinë me kriteret e mësipërme për çdo punonjës, subjekt i kësaj rregulloreje.

Neni 9

Detyrimi për procedurën e brendshme të certifikimit

1. Shoqëria komisionere/banka duhet të hartojë një procedurë të brendshme, me qëllim certifikimin e punonjësve sipas kriterëve të kësaj rregulloreje.
2. Procedura duhet të përmbajë të gjitha fazat për certifikim, nga shqyrtimi, miratimi ose refuzimi i personit që po certifikohet, shkaqet e refuzimit, afatet për çdo fazë, listën e dokumenteve/deklaratave të nevojshme, mënyrën e dorëzimit si dhe depozitimin e ruajtjen e tyre.

Neni 10

Dokumenti për aftësi dhe përshtatshmëri

1. Shoqëria komisionere/banka pajis punonjësën me dokumentin për aftësi dhe përshtatshmëri.
2. Lëshimi i dokumentit për aftësi dhe përshtatshmëri apo certifikimi i punonjësit bëhet vetëm kur këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës apo njësia përgjegjëse e bankës vlerëson dhe krijon bindje të arsyeshme se punonjësi është i aftë dhe i përshtatshëm për të kryer funksionin e caktuar.
3. Shoqëria komisionere/banka mban evidencë të të dhënave të çdo personi, të certifikuar si të aftë dhe të përshtatshëm dhe të çdo revokimi ose anulimi të certifikimit.

Neni 11

Forma dhe vlefshmëria e dokumentit për aftësi dhe përshtatshmëri

1. Dokumenti për aftësi dhe përshtatshmëri duhet të përmbajë minimalisht:
 - a. Vendimin e këshillit mbikëqyrës/administrimit të shoqërisë komisionere ose dokumentin e njësisë përgjegjëse të bankës, se personi i certifikuar është i aftë dhe i përshtatshëm për të kryer funksionin/funksionet për të cilin/cilat po lëshohet dokumenti;
 - b. Përshkrimin e aktiviteteve ku do të përfshihet personi në kuadër të realizimit të funksionit kyç që po i caktohet.
2. Dokumenti për aftësi dhe përshtatshmëri ka vlefshmëri për një periudhë 12 muaj, nga momenti i lëshimit të tij. Këshilli mbikëqyrës/këshilli i administrimit i shoqërisë komisionere ose njësia përgjegjëse pranë bankës rishqyrton të paktën një herë në vit vlefshmërinë e dokumentit.

Neni 12

Certifikimi në rast të ndryshimit të pozicionit të punonjësit

1. Në çdo rast të ndryshimit të pozicionit të punës të punonjësit të certifikuar, në një pozicion të ri që kërkon certifikim, shoqëria komisionere/banka duhet të ricertifikojë punonjësin sipas kërkesave për pozicionin e ri.
2. Nëse kërkesat për kualifikim dhe aftësi e përshtatshmëri janë të ndryshme nga ato të funksionit të mëparshëm, shoqëria komisionere/banka duhet të kryejë vlerësimin për certifikim përpara se punonjësi të nisë funksionin e ri.
3. Shoqëria komisionere/banka mund të mos lëshojë dokument të ri, nëse konstaton që nuk është i nevojshëm rivlerësimi si dhe nëse dokumenti është lëshuar me përmbajtje të gjerë që mbulon edhe funksionin e ri që kërkon certifikim.

Neni 13

Dokumenti për aftësi dhe përshtatshmëri që përfshin disa funksione

1. Nëse një person i punësuar pranë një shoqërie komisionere do të kryejë më shumë se një funksion, për të cilat kërkohet certifikim, shoqëria komisionere lëshon një dokument të vetëm për aftësi e përshtatshmëri.
2. Në çdo rast, shoqëria duhet të vlerësojë nëse punonjësi është i aftë dhe i përshtatshëm për të kryer të gjitha detyrat e nevojshme, me të cilat lidhet pozicioni që i ngarkohet.
3. Shoqëria, në një dokument të vetëm, përshkruan në terma më të gjerë funksionet që do kryhen nga personi dhe për të cilat kërkohet certifikim.

Neni 14

Refuzimi i Certifikimit

1. Nëse pas vlerësimit të kryer për përshtatshmërinë dhe aftësinë lidhur me një funksion të caktuar, këshilli i administrimit/ këshilli mbikëqyrës i shoqërisë komisionere ose njësia përgjegjëse pranë bankës vendos të mos certifikojë personin, shoqëria komisionere ose njësia përgjegjëse pranë bankës duhet të informojë personin nëpërmjet një njoftimi me shkrim.
2. Njoftimi duhet të përmbajë minimalisht:
 - a. Arsyet e mos certifikimit;
 - b. Hapat që sugjeron të ndjekë shoqëria në lidhje me personin, si pasojë e vendimit të marrë.

Neni 15

Certifikimi i punonjësit të degës apo zyrës së përfaqësimit të shoqërisë së huaj komisionere

Në rastin e shoqërisë së huaj komisionere, e cila ofron shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet regjistrimit të degës apo zyrës së përfaqësimit, shoqëria certifikon punonjës të degës, ose përfaqësues të zyrës, si dhe punonjës të do kryejë funksionin e brokerit, këshilltarit të investimeve, administratorit të portofolit, apo ofruesit të informacionit për klientin, në përputhje me këtë rregullore.

Neni 16

Emërimet emergjente

1. Në rast se shoqërisë komisionere /bankës i lind nevoja e zëvendësimit të një punonjësi të certifikuar, për shkak të largimit apo mungesës së tij, ajo vepron si më poshtë:
 - a. Mund të mos lëshojë certifikatë për zëvendësuesin për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, me kushtin që ka krijuar bindjen, bazuar në fakte, se është person i aftë dhe i përshtatshëm;
 - b. Merr masa që brenda 3 (tre) muajve të certifikojë personin që është i aftë dhe i përshtatshëm për atë pozicion;
 - c. Njofton me shkrim Autoritetin për zëvendësimin emergjent, duke dhënë argumentet përkatëse si dhe periudhën e zëvendësimit.

Neni 17

Revokimi i Certifikimit

1. Këshilli i administrimit/këshilli mbikëqyrës ose njësia përgjegjëse pranë bankës revokon miratimin për certifikimin e një punonjësi në këto raste:
 - a. punonjësi nuk i ruan kriteret fillestare, mbi bazën e të cilave u krye certifikimi;
 - b. konstatimit të parregullsive gjatë ushtrimit të funksionit;
 - c. certifikimi është dhënë mbi bazën e të dhënave të rreme;
 - d. nuk vepron në përputhje me rregullat e shoqërisë si dhe të legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi;
 - e. përfundon mandati i emërimit të personit;
 - f. përfundon kontrata e punës së personit me shoqërinë komisionere.
2. Revokimi i certifikimit të punonjësit mund t'i kërkohet shoqërisë komisionere/bankës nga Autoriteti, nëse konstatohet se:
 - a. Personi i certifikuar është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë, krimit ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarjjes, pastrimit e parave dhe financimit e terrorizmit;
 - b. Personi i certifikuar nuk i përmbush më kërkesat fillestare, në bazë të të cilave është certifikuar nga shoqëria komisionere;

- c. Personi i certifikuar ka shkelur me dashje rregullat e bursës ose të platformës shumëpalëshe të tregimit, duke u shkaktuar dëme ose humbje klientëve të shoqërisë ose pjesëmarrësve të tjerë të tregut, ose ka përdorur funksionin për përfitime vetjake në dëm të tyre;
- d. Ka informacion se personi i certifikuar ka shkelur rregullat ose rregulloret e një autoriteti të huaj kompetent.

Neni 18

Shkarkimi apo pezullimi i punonjësit me funksione kyçe

1. Autoriteti i kërkon shoqërisë komisionere ose bankës të shkarkojë ose të pezullojë për një periudhë kohore të përcaktuar një punonjës me funksione kyçe, përgjegjës për shkelje të legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Shoqëria komisionere ose banka informon menjëherë Autoritetin për shkarkimin apo pezullimin e personit.
3. Me shkarkimin e punonjësit humbet edhe vlefshmëria e dokumentit për aftësi e përshtatshmëri.
4. Në rast të pezullimit të punonjësit, dokumenti për aftësi e përshtatshmëri nuk është i vlefshëm gjatë periudhës së pezullimit.

KREU III

Kriteret e kualifikimit të punonjësve të shoqërisë komisionere që kryejnë funksione, objekt certifikimi

Neni 19

Kritere të përgjithshme

1. Shoqëria komisionere/banka duhet të sigurohet se punonjësit, që janë subjekt certifikimi, kanë njohuritë dhe aftësitë profesionale të përshtatshme, të vlerësuara përmes përfundimit me sukses të një kualifikimi, si dhe kanë fituar përvojën e duhur në ofrimin e shërbimit përkatës ndaj klientit, në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Kriteret për njohuritë dhe aftësitë profesionale duhet të jenë në përputhje me llojin e shërbimit që ofrohet, sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 20 dhe 21 të kësaj rregulloreje.
3. Niveli i njohurive dhe aftësive profesionale të një personi që ofron këshillime investimi apo administrim portofoli duhet të jetë i një standardi më të lartë se kriteret për njohuritë dhe aftësitë profesionale të një brokeri apo të individit që jep vetëm informacion mbi produktet dhe shërbimet e investimit.

Neni 20

Kriteret për njohuritë dhe aftësinë profesionale të punonjësve që japin informacion apo komunikojnë me klientin për marrjen dhe transmetimin e urdhrave (broker)

Personi që komunikon me klientin për t'i dhënë informacion apo për marrjen dhe transmetimin e urdhrave duhet të ketë njohurinë dhe aftësinë profesionale të nevojshme në mënyrë që:

1. Të kuptojë karakteristikat kyçe, riskun si dhe cilësinë e instrumenteve financiare dhe shërbimeve të ofruara nga shoqëria, përfshirë edhe çështjet e përgjithshme tatimore dhe kostot që do të mbarten nga klienti në kuadër të kryerjes së transaksionit. Njohuritë mbi instrumentet financiare komplekse janë veçanërisht të rëndësishme, në rast se shoqëria do të ofrojë këto produkte.
2. Të kuptojë llojin e tarifave, komisioneve dhe koston totale që do të ketë klienti gjatë kryerjes së transaksionit për instrumentin financiar, shërbimin e investimit apo shërbimin ndihmës që po ofrohet.
3. Të kuptojë karakteristikat dhe qëllimin e shërbimeve të investimit apo shërbimeve ndihmëse.
4. Të kuptojë si funksionojnë tregjet financiare dhe si ndikojnë ato në vlerën dhe çmimin e instrumenteve financiare që i ofrohen klientit.
5. Të kuptojë ndikimin e shifrave ekonomike dhe ngjarjeve ndërkombëtare/kombëtare/rajonale tek tregjet dhe produktet e investimit, për të cilat po jepet informacion.
6. Të kuptojë dallimin ndërmjet performancës së shkuar dhe skenarëve të performancës së ardhshme si dhe kufizimet që lidhen me parashikimin e bërë.
7. Të kuptojë çështje që lidhen me abuzimin e tregut dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.
8. Të kuptojë dhe vlerësojë të dhënat që lidhen me shërbimet e investimit/produktet e investimit, për të cilat po japin informacion si, dokumenti i informacionit kyç për investitorin, prospekte, pasqyrat financiare, apo të dhëna financiare.
9. Të kuptojë strukturat specifike të tregut për produktet e investimit, për të cilin japin informacion, vendet ku tregtohen ato, apo ekzistencën e ndonjë tregu tjetër sekondar.
10. Të ketë njohuri bazike të parimeve të vlerësimit të atyre produkteve të investimit, për të cilin po jep informacion.

Neni 21

Kriteret për njohuritë dhe aftësinë profesionale të personit që ofron këshillim në investime apo/dhe që administron portofolin

Punonjësi që ofron këshillim në investim dhe administrim portofoli ka njohuritë dhe aftësinë profesionale të nevojshme në mënyrë që:

1. Të kuptojë karakteristikat kyçe, riskun dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve që po ofrohen apo rekomandohen, përfshirë edhe çështjet e përgjithshme tatimore dhe kostot që do të mbarten nga klienti në kuadër të kryerjes së transaksionit. Njohuritë mbi instrumentet financiare komplekse janë veçanërisht të rëndësishme, në rast se shoqëria do të ofrojë këto produkte.
2. Të kuptojë llojin e tarifave, komisioneve dhe koston totale që do të ketë klienti gjatë kryerjes së transaksionit për instrumentin financiar, shërbimin e investimit apo shërbimin ndihmës që po ofrohet apo rekomandohet.
3. Të përmbushë detyrimin e kërkuar ndaj shoqërisë komisionere në lidhje me kërkesat për përshtatshmërinë e klientit.
4. Të kuptojë se si një lloj investimi i ofruar nga shoqëria mund të mos jetë i përshtatshëm për klientin, pasi ka vlerësuar informacionin e ofruar nga klienti përkundrejt ndryshimeve potenciale që mund të kenë ndodhur që nga mbledhja e informacionit.
5. Të kuptojë karakteristikat dhe qëllimin e shërbimeve të investimit apo shërbimeve ndihmëse.
6. Të kuptojë si funksionojnë tregjet financiare dhe si ndikojnë ato në vlerën dhe çmimin e produkteve të investimit që i ofrohen apo rekomandohen klientit.
7. Të kuptojë ndikimin e shifrave ekonomike dhe ngjarjeve ndërkombëtare/ kombëtare/ rajonale tek tregjet dhe produktet e investimit që i ofrohen apo rekomandohen klientit.
8. Të kuptojë dallimin ndërmjet performancës të së shkuarës dhe skenarëve të performancës së ardhshme si dhe kufizimet që lidhen me parashikimin e bërë.
9. Të kuptojë çështje që lidhen me abuzimin e tregut dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
10. Të kuptojë dhe vlerësojë të dhënat që lidhen me shërbimet/produktet e investimit që i ofrohen apo rekomandohen klientit si, dokumenti i informacionit kyç për investitorin, prospekte, pasqyrat financiare, apo të dhëna financiare.
11. Të kuptojë strukturat specifike të tregut për produktet e investimit që i ofrohen apo rekomandohen klientit, vendet ku tregtohen ato, apo ekzistencën e ndonjë tregu tjetër sekondar.

12. Të kenë njohuritë bazë të parimeve të vlerësimit të produkteve të investimit që i ofrohen apo rekomandohen klientit.
13. Të kuptojë bazat e menaxhimit të portofolit, përfshirë verifikimin për alternativat e investimit.

Neni 22

Kërkesa për përvojën e përshtatshme profesionale

1. Çdo punonjës, subjekt certifikimi sipas kësaj rregulloreje, duhet të plotësojë kërkesën e përvojës së përshtatshme profesionale. Afati minimal për plotësimin e kësaj kërkesë është të paktën 1 vit përvojë pune në pozicionin përkatës ose punë të ngjashme, me kohë të plotë.
2. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni është i zbatueshëm kur punonjësi ka diplomë të arsimit të lartë në përputhje me pozicionin e punës.
3. Për punonjës në pozicionin e brokerit, kërkesa për përvojë profesionale është të paktën 2 (dy) vjet në rast se diploma e arsimit të lartë është e ndryshme nga diploma në fushën e ekonomisë.
4. Për punonjës në pozicionin e këshilltarit në investime apo administrimin e portofolit, kërkesa për përvojë profesionale është të paktën 3 (tre) vjet në fushën e tregjeve financiare.
5. Kërkesa e përvojës së përshtatshme profesionale për funksionarët kryesorë paraqitet në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Kërkesa për kualifikim dhe aftësi profesionale

1. Shoqëria komisionere/banka në procesin e certifikimit kryen verifikimin e kualifikimeve profesionale minimale të punonjësve, mbështetur në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - a. Vlerëson punonjës në bazuar mbi një trajnim të jashtëm për kualifikime profesionale në përputhje me kërkesat e nenit 24, ose bazuar në kualifikimet e ofruara nga institucione të njohura, sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje;
 - b. Trajnon punonjës dhe vlerëson njohuritë dhe aftësitë profesionale të tij sipas një procedure të brendshme. Programet dhe modulet e trajnimit të brendshëm miratohen nga Autoriteti.
2. Shoqëria komisionere/banka mund të konsiderojë edhe një kombinim të të dyja formave të vlerësimit sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Shoqëria komisionere/banka duhet të ndërmarrë rregullisht hapa për vlerësimin e cilësisë dhe efektivitetin e trajnimeve.

Neni 24

Trajnimi jashtë shoqërisë/bankës

1. Trajnimi i jashtëm për kualifikim profesional mund të ofrohet nga një qendër/organizëm ndërkombëtar trajnimesh, dhe/ose institucione trajnimi të njohura nga rregullatorët e vendeve të Bashkimit Evropian ose të një vendi që është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).
2. Trajnimi për kualifikim profesional mund të ofrohet nga një qendër/institucion trajnimi brenda vendit, sipas kërkesave të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti.
3. Kohëzgjatja minimale e trajnimit, modulet e të cilit mbulojnë të gjitha çështjet e neneve 20 dhe 21, duhet të jetë 60 orë dhe mund të merret fizikisht ose në distancë nëpërmjet formateve digjitale apo edhe një kombinim i të dyjave.
4. Programi i trajnimit për punonjës të punësuar si këshilltar në investime dhe administrator portofoli duhet të jetë më i avancuar se për punonjës të punësuar si broker, punonjës që jep informacione për klientët, apo për agjentin e lidhur.
5. Trajnimi për kualifikim profesional duhet të dokumentohet nëpërmjet një certifikate apo vërtetimi, pas përfundimit me sukses të testimit të njohurive.
6. Dokumentet mbi programet e trajnimit duhet të ruhen nga shoqëria për një periudhë minimale prej 5 vitesh dhe vihen në dispozicion të Autoritetit në çdo kohë, me kërkesë të tij.
7. Përveç sa është parashikuar në këtë nen dhe në nenin 23 të kësaj rregulloreje, kërkesa për kualifikim do të konsiderohet e përmbushur:
 - a. Në rastin kur punonjësi që do kryejë funksionin e brokerit, ka punuar të paktën 3 vjet ku si pjesë e pozicionit të punës:
 - (i) Ka kryer transaksione në instrumente financiare,
 - (ii) Ka qenë pjesë e strukturave mbështetëse për ekzekutimin e transaksioneve në instrumente financiare,
 - (iii) Ka aplikuar ose vlerësuar të dhëna ekonomiko financiare, dhe/ose statistikore si pjesë e vendimmarrjes së procesit të investimeve në instrumente financiare;
 - (iv) Ka qenë pjesë e strukturave mbikëqyrëse/drejtuese/kontrolluese të aktiviteteve që përfshihen në një nga pikat (i), (ii), apo (iii);
 - (v) Ka ushtruar një funksion mbikëqyrës apo rregullator në lidhje me aktivitetet e mësipërme.

- b. Në rastin kur punonjësi që do kryejë funksionin e këshilltarit në investime/administratorit të portofolit, ka punuar të paktën 5 vjet ku si pjesë e pozicionit të punës:
- (i) Ka kryer transaksione në instrumente financiare;
 - (ii) Ka qenë pjesë e strukturave mbështetëse për këshillimin/dhënien e rekomandimeve në instrumente financiare;
 - (iii) Ka aplikuar ose vlerësuar të dhëna ekonomiko financiare, dhe/ose statistikore si pjesë e vendimmarrjes së procesit të investimeve në instrumente financiare;
 - (iv) Ka qenë pjesë e strukturave mbikëqyrëse/drejtuese/kontrolluese të aktiviteteve që përfshihen në një nga pikat (i), (ii), apo (iii);
 - (v) Ka ushtruar një funksion mbikëqyrës apo rregullator në lidhje me aktivitetet e mësipërme;
- c. Në rastin e funksionarit kryesor, kur ka përvojë pune sipas shtojcës 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 25

Punonjësi nën mbikëqyrje

1. Punonjësi që nuk ka kualifikimin dhe/ose përvojën e duhur për pozicionin, mund ta kryejë funksionin që i caktohet vetëm duke punuar nën mbikëqyrje, derisa të fitojë kualifikimin dhe përvojën e duhur.
2. Niveli i mbikëqyrjes duhet të jetë në varësi të kualifikimit dhe përvojës së personit që po mbikëqyret, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen gjatë takimeve me klientët apo komunikimit me to nëpërmjet formave të tjera të komunikimit si telefon apo e-mail.
3. Shoqëria duhet të sigurohet që personi që po mbikëqyr të ketë certifikimin për njohuritë dhe aftësitë e nevojshme profesionale për të vepruar si i tillë.
4. Shoqëria duhet të sigurohet që mbikëqyrja e punonjësit është në varësi të llojit të shërbimit që po ofrohet.
5. Mbikëqyrësi mban përgjegjësi për punonjësin nën mbikëqyrje, sikur po e ofron vetë atë shërbim.

Neni 26

Dosja e kualifikimeve për certifikim

Shoqëria Komisionere mban dosjen përkatëse të kualifikimeve të çdo personi që certifikon, e cila përmban:

- a. Diplomën e arsimit të lartë në fushën përkatëse. Shoqëria ka përgjegjësinë të verifikojë që diplomat e paraqitura nga punonjësit janë të përshtatshme me funksionin që po ushtrohet dhe duhen rishikuar sa herë është e nevojshme, sidomos në rastet kur personi ndryshon departament apo ushtron funksione të reja;

- b. Dokument që vërteton përfundimin e kualifikimit profesional ose trajnimit të përcaktuar sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;
- c. Informacion mbi mbikëqyrësin e punonjësit që nuk ka kualifikimin dhe / apo përvojën e përshtatshme profesionale;
- d. Informacion përmbledhës mbi vlerësimin e plotësimit të kriterëve të njohurive dhe aftësive profesionale përpara miratimit nga organi kompetent.

Neni 27
Dispozita Kalimtare

Të gjithë personat e licencuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879 datë 21.2.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë, dhe brenda 3 muajve para përfundimit të afatit për përshtatshmëri sipas kërkesave të Ligjit, duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi dhe përshtatshmëri sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 28
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Shtojca 1: Tabela e Kualifikimeve Ndërkombëtare të njohura nga Autoriteti

Ofruesi i Kualifikimit	Kualifikimi	Lloji i Aktivitetit
The Financial Markets Association	Diploma ACI	Këshilltar në Investime/ Administrator Portofoli
	ACI Dealing Certificate	Broker /Këshilltar në Investime
	ACI Operations Certificate	Broker/Këshilltar në Investime/Administrator Portofoli
Association of Chartered Certified Accountants (ACCA)	Anëtar	Drejtor Departamenti i Financës
Association of International Wealth Manager	Certified International Wealth Manager (CIWM)	Administrator Portofoli/Këshilltar në Investime
Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)	Kontabël i Miratuar (KM)	Drejtor Departamenti i Financës / Drejtor Departamenti i Auditit të Brendshëm
	Auditues Ligjor	Drejtor Departamenti i Financës / Drejtor Departamenti i Auditit të Brendshëm
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Auditues i Brendshëm	Drejtor, Departamenti i Auditit të Brendshëm
Chartered Institute of Internal Auditors	Certified Internal Auditor (CIA)	Drejtor Departamenti i Auditit të Brendshëm
Canadian Securities Institute	Canadian Securities Course (CSC)	Broker/punonjës të tjerë që i japin informacion klientit

	<p>Derivatives Fundamentals Course (DCF) dhe/apo Options Licensing Course (OLC)</p> <p>Certificate in Equity Trading and Sales</p>	<p>Këshilltar në Investime/Administrator Portofoli</p> <p>Broker</p>
CFA Institute	The CFA Investment Foundations Certificate	Broker/punonjës që japin informacion për klientin
	Niveli 1 (level 1) i Programit CFA	Broker/Punonjës që japin informacion për klientin/Këshilltar në Investime
	CFA (të tre nivelet)	Këshilltar në Investime/Administrues Portofoli/ Drejtore i Departamentit të Financës/ Drejtore Departamenti i Auditit të Brendshëm
CFA Society UK	Investment Management Certificate (IMC)	Broker/Këshilltar në Investime/Administrues Portofoli
Certified Financial Planner Board of Standards	Certified Financial Planner (CFP)	Administrues Portofoli

Chartered Insurance Institute	Certificate in Securities Advice and Dealing (Level 4)	Këshilltar në Investime/Administrues Portofoli
Chartered Alternative Investment Analysis Association (ACAIA)	CAIA Level 1	Broker/Këshilltar në Investime
The Chartered Institute of Public Finance and Accountancy	Anëtar	Drejtor Departamenti i Financës/Drejtor Departamenti i Auditit të Brendshëm
The Chartered Institute for Securities and Investments (CISI)	Investments Operations Certificate (IOC) (me modulën Asset Servicing) Investment Operations Certificate (IOC) me modulën Client money and Assets Investment Operations Certificate (IOC) me modulën Administration of Settlement and Investments Investment Operations Certificate (me modul Global Securities Operations)	Broker/ Punonjës që jep informacion
	Investments Advice Certificate Investment Advice Diploma	Këshilltar në Investime
The Chartered Institute for Securities and Investments (CISI)	Level 3 Certificate in Investments	Broker/Kështilltar në Investime
	Level 6 Diploma in Wealth Management	Administrues Portofoli
	Advanced Certificate in Global Securities Operations) (level 5) Diploma in Investment Operations (Level 6+)	Broker/Këshilltar në Investime Këshilltar në Investime/Administrues Portofoli

	Managing Operational Risk in Financial Institutions (Level 4+)	Drejtore, Departamenti i Administrimit të Riskut
Investment Management Consultants Association	Certified Investment Management Analyst (CIMA)	Drejtore, Departamenti i Financës/Drejtore Departamenti i Auditit të Brendshëm
Association of Certified International Investment Analysts (ACIIA)	Certified International Investment Analyst (CIIA)	Këshilltar në Investime/Administrues Portofoli/Drejtore Departamenti i Financës
Deutsche Boerse	Certified Securities Trader/Certified Derivatives Trader	Broker
Global Association of Risk Professionals (GARP)	Financial Risk Manager (FRM)	Broker/Këshilltar në Investime/Administrues Portofoli/Drejtore Departamenti i Administrimit të Rrezikut/Drejtore Departamenti i Financës
International Capital Market Association (ICMA)	Financial Markets Foundation Qualification (FMFQ)	Këshilltar në Investime/Broker/Punonjës që japin informacion
Institute of Management Accountants (IMA)	Certified Management Accountant (CMA)	Drejtore Departamenti i Financës/Drejtore Departamenti i Auditit të Brendshëm
International Compliance Association	ICA Certificate in Compliance	Drejtore Departamenti i

		Përputhshmërisë
International Compliance Association	International Certificate in Anti Money Laundering	Drejtore Departamenti i Parandalimit dhe Pastrimit të Parave
International Capital Market Association	Financial markets Foundation Qualification (FMFQ)	Broker / Këshilltar në Investime
Association of Certified Anti Money Laundering Specialist (ACAMS)	Certified Anti-Money Laundering Specialist designation	Drejtore, Departamenti i Parandalimit të Pastrimit të Parave
Association of Chartered Certified Accountants (ACCA)	Certificate in Audit (Level 4)	Drejtore, Departamenti i Auditimit të Brendshëm/Drejtore Departamenti i Financës
Association of International Accountants (AIA)	AIA	Drejtore Departamenti i Financës/Drejtore, Departamenti i Auditit të Brendshëm
Association of International Certified Professional Accountants	Certified Public Accountant (CPA)	Drejtore, Departamenti i Auditimit të Brendshëm/Drejtore, Departamenti i Financës
The European Federation of Financial Analysts Societies (EFFA)	Certified European Financial Analyst (CEFA)	Këshilltar në Investime/Administrues Portofoli/Drejtore, Departamenti i Financës/Drejtore, Departamenti i Auditit të Brendshëm
Professional Risk Managers's International Association (PRMIA)	Professional Risk Manager	Drejtore, Departamenti i Administrimit të Riskut

Shtojca 2: Kualifikimi dhe përvoja profesionale për funksionarët kryesorë të Shoqërisë Komisionere

Pozicioni	Kualifikimi dhe Përvoja Profesionale
Drejtor i Departamentit të Financës	<p>Kandidati duhet të ketë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Diplomë brenda ose jashtë vendit në fushën e ekonomisë.2. Të paktën 1 vit eksperiencë pune në mbylljen e pasqyrave financiare dhe kualifikimin përkatës. <p>Kërkesa për kualifikim do të konsiderohet e përmbushur në rastin kur punonjësi ka punuar të paktën 3 vjet, ku si pjesë e pozicionit të punës, ka kryer një nga më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none">(i) Ka aplikuar standarde ndërkombëtare apo kombëtare të raportimit financiar në hartimin, përgatitjen e pasqyrave financiare,(ii) Ka qenë pjesë e strukturave mbikëqyrëse/drejtuese/kontrolluese të njësisë së financë/kontabilitetit;(iii) Ka asistuar në procesin e planifikimit, buxhetimit, raportimit dhe kontrollit financiar apo në auditim.
Drejtor i Departamentit të Përputhshmërisë Drejtor i Departamentit të Parandalimit të Pastrimit të Parave	<p>Kandidati duhet të ketë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Diplomë në fushën e drejtësisë / ekonomisë.2. Të paktën 1 vit eksperiencë pune që lidhet drejtpërsëdrejti me funksionin dhe kualifikimin përkatës. <p>Kërkesa për kualifikim do të konsiderohet e përmbushur në rastin kur punonjësi ka punuar të paktën 3 vjet, ku si pjesë e pozicionit të punës, ka kryer një nga më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none">(i) Ka kryer transaksione në instrumenta financiare;(ii) Ka qenë pjesë e strukturave mbështetëse për ekzekutimin e transaksioneve

	<p>në instrumente financiare;</p> <ul style="list-style-type: none"> (iii) Ka qenë pjesë e strukturave inspektuese në institucione financiare; (iv) Ka qenë pjesë e strukturave mbikëqyrëse/drejtuese të aktiviteteve që përfshihen në një nga pikat (i), (ii), apo (iii); (v) Ka hartuar dhe implementuar politika të brendshme në përputhje me kuadrin rregullativ dhe legjislativ të tregut financiar; (vi) Është përfshirë në procesin e hartimit të procedurave për sigurimin e përputhshmërisë me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi; apo në procesin e hartimit të politikave dhe procedurave të brendshme të përputhshmërisë për çështje të parandalimit të pastrimit të parave në sektorin financiar; (vii) Është përfshirë në procesin e auditit të brendshëm apo të jashtëm dhe strukturat e kontrollit të brendshëm të një institucioni financiar; (viii) Është përfshirë në strukturat e menaxhimit të rrezikut të një institucioni financiar; (ix) Ka asistuar në zhvillimin dhe implementimin e programeve AML brenda një institucioni financiar apo përfshirë në procesin e sigurimit të përputhshmërisë me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi për Parandalimin e Pastrimit të Parave; (x) Është përfshirë në procesin e ruajtjes së të dhënave të klientëve me risk dhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta tek rregullatorët; (xi) Ka ushtruar një funksion mbikëqyrës apo rregullator në lidhje me aktivitetet e mësipërme.
<p>Drejtor i Departamentit të Administrimit të Riskut</p>	<p>Kandidati duhet të ketë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Diplomë brenda ose jashtë vendit në fushën e ekonomisë. 2. Të paktën 1 vit eksperiencë pune që lidhet drejtpërsëdrejti me funksionin dhe

	<p>kualifikimin përkatës.</p> <p>Kërkesa për kualifikim do të konsiderohet e përmbushur në rastin kur punonjësi ka punuar të paktën 3 vjet, ku si pjesë e pozicionit të punës, ka kryer një nga më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Ka kryer transaksione në instrumente financiare; (ii) Ka qenë pjesë e strukturave mbështetëse për ekzekutimin e transaksioneve në instrumente financiare; (iii) Ka aplikuar ose vlerësuar të dhëna ekonomiko financiare, dhe/ose statistikore si pjesë e vendimmarrjes së procesit të investimeve në instrumente financiare; (iv) Është përfshirë në strukturat e administrimit të rrezikut apo kontrollit të brendshëm të institucionit financiar; (v) Ka qenë pjesë e strukturave mbikëqyrëse/drejtuese të aktiviteteve që përfshihen në një nga pikat e mësipërme; (vi) Ka ushtruar një funksion mbikëqyrës apo rregullator në lidhje me aktivitetet e mësipërme.
<p>Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm</p>	<p>Kandidati duhet të ketë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Diplomë brenda ose jashtë vendit në fushën e ekonomisë. 2. Të paktën 1 vit eksperiencë pune në auditim dhe kualifikimin përkatës. <p>Kërkesa për kualifikim do të konsiderohet e përmbushur në rastin kur punonjësi ka punuar të paktën 3 vjet, ku si pjesë e pozicionit të punës, ka kryer një nga më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Ka hartuar, përgatitur pasqyra financiare në institucione financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare apo kombëtare të raportimit financiar; (ii) Është përfshirë në operacionet apo strukturat e kontrollit të brendshëm të një institucioni financiar;

	<ul style="list-style-type: none">(iii) Ka kryer vlerësim dhe planifikim të rrezikut apo është përfshirë në përdorimin e teknikave të menaxhimit të rrezikut;(iv) Ka kryer funksione finance pranë një institucioni financiar;(v) Ka qenë pjesë e strukturave mbështetëse për ekzekutimin e transaksioneve në instrumente financiare;(vi) Ka qenë pjesë e strukturave inspektuese në një institucion financiar;(vii) Ka qenë pjesë e strukturave mbikëqyrëse/drejtuese të aktiviteteve që përfshihen në një nga pikat e mësipërme;(viii) Ka ushtruar një funksion mbikëqyrës apo rregullator në lidhje me aktivitetet e mësipërme.
--	---